



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Tiranë më

Nr.

protnumber

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN
PËR

“DËRGIMIN E KUTIVE REZERVË NË CDO KZAZ PËR ADMINISTRIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025”

1. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektakte me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat e detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje.

2. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në përputhje me nenin 20, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, propozohet miratimi i ndryshimeve dhe shtesave në Kodin Zgjedhor, me qëllim përmirësimin e procesit zgjedhor dhe rritjen e integritetit të tij.

Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025, do të përmbajë emrat e subjekteve zgjedhore, partive politike dhe koalicioneve, emrat e kandidatëve në listën shumëmemërore (ata në listë të “mbyllur” dhe ata në listë “të hapur”), si dhe shkrime, apo elementë të tjerë figurativ.

Për shkak të përmbajtjes së zgjeruar, fleta e votimit pritet të ketë përmasa më të mëdha se ato të përdorura zakonisht. Si rezultat, në disa qendra votimi, veçanërisht ato me numër të lartë zgjedhësish, mund të shfaqen vështirësi në depozitimin e fletëve në kutitë e votimit, aktualisht në përdorim nga KQZ. Në këto kushte, kapaciteti i kutive, mund të jetë i pamjaftueshëm për të akomoduar numrin dhe madhësinë e fletëve pa shkaktuar problematika operacionale apo vonesa gjatë procesit të votimit.

Fleta e votimit që do të përdoret do të jetë format A3+ i zgjatur, me dimensione 297 x 600 mm. Në këtë kontekst, KQZ ndërmoi një vlerësim teknik për të përcaktuar ndikimin e madhësisë së fletës së votimit në administrimin e procesit zgjedhor. Për këtë qëllim, u realizua një simulim i procesit të votimit, duke përdorur fletë votimi eksperimentale në formatet A3+, A3 të zgjatur, dhe A2, me gramatura të ndryshme. Këto testime u kryen për të vlerësuar ndikimin e madhësisë së

fletës së votimit në procesin e depozitimit të saj në kutitë standarde të votimit, duke marrë në konsideratë përmasa që mund të jenë të përshtatshme për përdorim.

KQZ, realizoi një simulim me fletë eksperimentale në formatet A2, A3+, A3 i zgjatur, (me gramaturë 80gr dhe 90gr me watermark), për të vlerësuar ndikimin në depozitimin e fletëve në kutitë ekzistuese (83 litra).

Gjatë testimeve u konstatua se:

- Fletët A2 janë më problematike, për shkak të palosjes dhe shfrytëzimit joefektiv të hapësirës,
- Fletët **A3 i zgjatur** rezultuan më praktike, më fleksibël në palosje dhe shfrytëzonin më mirë hapësirën në kuti.
- Gramatura 90 gr/m² krijon strukturë më uniforme, por ul kapacitetin e kutisë me ~13%.
- Në kutinë standarde u arrit të depozitohen 650 fletë A3 i zgjatur (80 gr) ose 550 fletë A3 i zgjatur (90 gr watermark),

U krye analiza e zgjedhjeve të viteve 2021 dhe 2023, për të identifikuar qendrat me numër të lartë votuesish, duke përdorur kufijtë e pragut mbi 550, 650, 750 dhe 850 zgjedhës/QV.

Nga analiza rezultoi se rreth **3917 QV** në vitin 2023 kishin më shumë se 550 zgjedhës, ndërsa **1017 QV** kishin mbi 850 zgjedhës, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të mbushjes së kutive përpara përfundimit të procesit të votimit.

Për të parashikuar qendrat e votimit që mund të rrezikojnë mbushjen e parakohshme të kutive (numri i votuesve është më i madh se kapaciteti që mund të mbajnë kutitë e votimit), u analizuan të dhënat e pjesëmarrjes në zgjedhjet e viteve 2021 dhe 2023. Kjo analizë ofron një model për identifikimin e qendrave, ku mund të lindë nevoja për masa shtesë në zgjedhjet e ardhshme.

Më poshtë paraqitet numri i qendrave të votimit, sipas fashave të pjesëmarrjes së votuesve, në rang vendi për vitet 2021 dhe 2023, të cilat shërbejnë si model parashikues për zgjedhjet e ardhshme:

Qarqet	Numër QV-sh > 350 Votues		Numër QV-sh > 450 Votues		Numër QV-sh > 550 Votues		Numër QV-sh > 650 Votues	
	2023	2021	2023	2021	2023	2021	2023	2021
Berat	25	75	5	12	1	1	0	0
Dibër	57	74	13	21	0	4	0	0
Durrës	81	197	8	49	1	7	0	1
Elbasan	88	206	7	76	0	4	0	1
Fier	51	204	1	42	0	3	0	0
Gjirokastrë	29	47	7	11	1	0	0	0
Korçë	58	139	8	37	1	6	0	0
Kukës	59	41	21	17	4	6	0	0
Lezhë	53	86	3	11	0	0	0	0
Shkodër	62	93	18	26	1	1	0	0
Tiranë	461	736	27	359	0	126	0	20
Vlorë	28	65	2	8	0	2	1	1
Total	1052	1963	64	669	9	160	1	23

Duke qenë se pjesëmarrja e saktë e zgjedhësve nuk mund të dihet paraprakisht, por mund të parashikohet, bazuar në modelet e dy proceseve të fundit zgjedhore, është e rëndësishme të merren masa, duke u bazuar në numrin total të zgjedhësve të regjistruar.

Më poshtë janë identifikuar numri i qendrave të votimit të cilat kanë numër zgjedhësish më të madh se kapaciteti i kutive të votimit (*mund të ekspozohet rreziku i mbushjes së parakohshme të kutive*), duke u bazuar në pragjet 550, 650, 750, dhe 850 zgjedhës si me poshtë:

Qarku	Mbi 550 zgjedhës	Mbi 650 zgjedhës	Mbi 750 zgjedhës	Mbi 850 zgjedhës
Berat	191	114	65	36
Dibër	105	65	33	17
Durrës	434	360	232	101
Elbasan	350	274	191	118
Fier	437	315	200	97
Gjirokastrë	103	68	45	24
Korçë	288	193	117	54
Kukës	73	47	38	26
Lezhë	186	145	95	57
Shkodër	293	197	127	72
Tiranë	1,096	883	578	307
Vlorë	361	283	180	108
Total	3,917	2,944	1,901	1,017

Bazuar në të dhënat e analizuara, si dhe në përvojën e zgjedhjeve të vitit 2023, të cilat diktojnë nevojën e marrjes së masave dhe përcaktimit të procedurave për rastet kur kutia e votimit mund të mbushet parakohe dhe del nevoja e përdorimit të një kutie rezervë.

Projektvendimi adreson pikërisht këtë situatë. Ky vendim synon të garantojë vijueshmërinë dhe integritetin e procesit të votimit në rastet kur kutia standarde e votimit mbushet përpara përfundimit të procesit. Ai parashikon mënyrën e përdorimit të **kutive rezervë** dhe rregullat e detajuara për dokumentimin, verifikimin dhe transparencën e këtij procesi.

2. Parashikimet kryesore të aktit

- **Kutitë rezervë** shpërndahen paraprakisht në çdo KZAZ për t'u përdorur sipas nevojës.
- **KQV-ja**, kur konstaton se kutia nuk mund të pranojë më fletë votimi, merr vendim për kërkesë për kuti rezervë dhe njofton KZAZ-në.
- **KZAZ-ja** verifikon dhe regjistron rastin në Librin e Protokollit dhe dërgon kutinë rezervë me 5 kode sigurie të veçanta dhe me ngjyrim/emërtim dallues.
- Kutia rezervë shoqërohet **nga dy anëtarë të KZAZ me përkatësi të kundërt politike**, të cilët asistojnë rifillimin e votimit në QV.

3. Dokumentimi i përdorimit të kutisë rezervë

- KQV harton **Procesverbalin e Mbylljes së Kutisë së parë** dhe kalimit në kutinë rezervë, duke përshkruar në detaje ngjarjen, oraret, numrin e zgjedhësve të identifikuar, fletët e përdorura, të papërdorura dhe të dëmtuara.
- Të gjitha këto të dhëna shënohen edhe në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së**.
- Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, përfshirë vërejtjet (nëse ka).
- Vëzhguesve u tregohet kutia bosh dhe procesi i mbylljes dhe hapjes së kutisë rezervë zhvillohet në përputhje me Kodin Zgjedhor.

4. Veprimet pas përfundimit të votimit

Në fund të ditës, për të dyja kutitë hartohen procesverbalë të veçantë dhe kopje të tyre vendosen sipas rregullores në:

- kutinë e votimit,
- kutinë e materialeve,
- u shpërndahen anëtarëve të KQV dhe vëzhguesve.

5. Marrja në dorëzim nga KZAZ

- KZAZ plotëson Procesverbalin e Konstatimit, kur merr dy kuti votimi nga një QV, duke evidentuar përdorimin e kutisë rezervë, vulat dhe gjendjen e tyre.
- Nëse konstatohet parregullsi (vulë e këputur, kuti e dëmtuar, format jo standard etj.), ajo **shënohet si “Kuti e Parregullt”** dhe i nënshtrohet procedurës sipas nenit 115, e vijim të Kodit Zgjedhor.

6. Rregullat për Grupin e Numërimit

- Çdo kuti numërohet veçmas.
- Plotësohet një **tabelë përmbledhëse për secilën kuti**, si dhe një tabelë agreguese për të konsoliduar rezultatet.
- Kutitë e shpallura të parregullta nuk i nënshtrohen numërimit, por dokumentohen në mënyrë të veçantë.

Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për dërgimin e kutive rezervë në çdo KZAZ, për administrimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11 maj 2025”

Erion META –Drejtorja e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOÇAJ –Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM
PËR
“DËRGIMIN E KUTIVE REZERVË NË ÇDO KZAZ PËR ADMINISTRIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025”

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “g”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

Neni 1

Procedurat për dorëzimin e kutive rezervë dhe rregullat që duhet të ndjekë KQV

1. Në çdo KZAZ dërgohen kuti rezervë, për administrimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 11 maj 2025.
2. Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV) kur vëren se në kutinë e votimit nuk mundësohet hedhja e fletëve të votimit, merr vendim t’i kërkojë KZAZ-së, sigurimin e kutisë rezervë të votimit.
3. KZAZ-ja evidenton dhe shënon këtë fakt në Librin e Protokollit, dhe pasi merr vendim për pajisjen e KQV-së me kutinë rezervë të votimit, njofton menjëherë KQZ-në.
4. KZAZ-ja pas verifikimit të kërkesës nga KQV, dërgon një kuti votimi rezervë në QV, së bashku me 5 kodet rezervë të sigurisë, me procesverbal dorëzimi. Kutia rezervë e votimit dhe 5 kodet e sigurisë rezervë, duhet të kenë elementë identifikimi me ngjyrë dhe emërtim të veçantë.
5. Kutia rezervë dërgohet/përcillet pranë KQV-së, nga dy përfaqësues të KZAZ-së (me përfaqësi të kundërt politike), të cilët, monitorojnë procesin e rifillimit të votimit në kutinë rezervë të votimit. Me mbërritjen e kutisë rezervë, nëse procesi i votimit nuk është pezulluar, KQV-ja merr vendim për pezullimin e votimit dhe e regjistron vendimin/rastin në Librin e protokollit të Mbledhjeve.
6. KQV, u tregon vëzhguesve kutinë rezervë të votimit të zbrazët dhe e mbyll atë.
7. KQV-ja harton menjëherë një “Procesverbal të Mbylljes së Kutisë së Votimit dhe përdorimit të kutisë rezervë të votimit”, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar ngjarja/fakti, dhe:

Data: 00.0.2025 Nr: 000
Ora: 00:00



“Për dërgimin e kutive rezervë të votimit në çdo KZAZ për administrimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025”

- a. Data dhe ora e saktë;
 - b. Numri i zgjedhësve që janë identifikuar nga pajisja PEI, deri në momentin e pezullimit të procesit të votimit, nëpërmjet skanimit me QR code nga operatori në rast se është përdorur PEI, ose nga lista e zgjedhësve që kanë nënshkruar, në rast se nuk është përdorur PEI;
 - c. Numrin e fletëve të votimit që gjenden në kutinë e mbushur;
 - d. Kodin e pestë të sigurisë, me të cilën do të mbyllet kutia e votimit;
 - e. Sasinë e fletëve të votimit të përdorura;
 - f. Numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
 - g. Gjithashtu, në “Procesverbalin e Mbylljes së Kutisë së Votimit dhe përdorimit të kutisë rezervë të votimit” do të shënohen edhe kodet e vulave të sigurisë, të vendosura paraprakisht në kutinë rezervë;
 - h. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Nëse ndonjë nga anëtarët e KQV-së ka vërejtje, ato shënohen në hapësirën e posaçme për vërejtjet, në procesverbal.
 - i. Nga një kopje e “Procesverbalit të Mbylljes së Kutisë së Votimit dhe përdorimit të kutisë rezervë të votimit” do të depozitohet përkatësisht në kutinë e votimit, kutinë rezervë të votimit dhe në kutinë e materialeve të votimit.
8. Të gjitha të dhënat e kutisë rezervë të votimit, regjistrohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, për të garantuar transparencën dhe gjurmueshmërinë e procesit.
 9. Pasi është siguruar që kutia e votimit është mbyllur rregullisht (me kodin e 5-të) dhe është siguruar në ambientet e QV-së, dhe pas vulosjes së kutisë rezervë të votimit, përfaqësuesit e KZAZ-së autorizojnë KQV-në të vijojë me procedurat e votimit.
 10. Në fund të procesit të votimit, plotësohet procesverbali për mbylljen e votimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KQV-së. Nëse ndonjë nga anëtarët e KQV-së ka vërejtje, ato shënohen në hapësirën e posaçme për vërejtjet, në procesverbal. Ky procesverbal plotësohet në 3 kopje.
 11. Kopja e parë (origjinali i Procesverbalit për Mbylljen e Votimit) futet në kutinë rezervë të votimit, e cila vuloset menjëherë me kodin e fundit të sigurisë;
 12. Kopja e dytë e Procesverbalit për Mbylljen e Votimit, futet në kutinë e materialeve të votimit, e cila më pas vuloset me kodet përkatëse të sigurisë;
 13. Kopja e tretë e Procesverbalit për Mbylljen e Votimit u jepet anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të QV-së.

Neni 2

Dorëzimi i kutive të materialeve të votimit në KZAZ

1. Kur KZAZ-ja merr në dorëzim në Vendin e Numërimit të Votave, materialet zgjedhore të sjella nga KQV-ja, e cila ka përdorur kuti rezervë, ajo plotëson Procesverbalin e Konstatimit, në të cilin evidenton:
 - Faktin se për atë QV është dorëzuar edhe një kuti rezervë votimi;
 - Arsytet e përdorimit të kutisë rezervë;
 - Numrat e identifikimit të kutive dhe vulave të tyre;
 - Kryhen vlerësimet përkatëse, në përputhje me nenin 115, të Kodit Zgjedhor.
2. Në rast se, gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë me materialet e votimit, grupi i marrjes në dorëzim konstaton se:
 - a. mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie;

- b. vendosja e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
- c. kutia ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materialit tjetër të votimit; ose
- ç. kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara nga KQZ-ja;

atëherë, grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë KZAZ-në për parregullsinë, dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet si “KUTI E PARREGULLT”. Parregullsia e konstatuar, shënohet në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

3. Në rastet kur, për një qendër votimi, gjatë marrjes në dorëzim të kutive nga grupet e marrjes në dorëzim për kutitë me fletët e votimit, konstatohet parregullsi për njërën nga kutitë me fletët e votimit, atëherë ajo kuti vlerësohet si “KUTI E PARREGULLT” dhe dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia me materialet e votimit dhe kutia tjetër me fletët e votimit, i nënshtrohen procedurave, sipas neneve 116 deri në 119, të Kodit Zgjedhor.

Neni 3

Radha e veprimeve nga Grupet e numërimit

1. Numërimi fillon me kutinë e votimit dhe vijon me kutinë rezervë. Në rast se një kuti rezulton e parregullt, ajo nuk i nënshtrohet procesit të numërimit dhe procesi vijon me kutinë e rregullt.
2. Gjatë procesit të numërimit, për qendrat e votimit, në të cilën është përdorur kutia e votimit rezervë, grupi i numërimit për kutinë e parë plotëson me shkrim dore për subjektet tabelën përkatëse të rezultateve për QV-në, ku subjektet janë paraprintuar. Rubrikat që plotësohen në këtë kuti janë:
 - numri i fletëve të votimit të gjendura në kuti;
 - votat e pavlefshme;
 - votat e vlefshme gjithsej dhe shpërndarjen e tyre, sipas subjekteve, si dhe
 - kodet e vulave të sigurisë, me të cilat mbyllet kjo kuti.
3. Më pas, grupi i numërimit fillon procedurën e vlerësimit dhe numërimit të votave në kutinë rezervë dhe në përfundim të vlerësimit dhe numërimit shënon në modelin përkatës të tabelës së rezultateve për QV-në, numrin e zgjedhësve që kanë votuar, përfshi sa gra në këtë qendër votimi, fletë votimi të papërdorura, nëse ka për këtë QV, numrin e fletëve të votimit të dëmtuara, nëse ka, numrin e fletëve të votimit të gjendura në kuti, votat e pavlefshme dhe të vlefshme gjithsej për këtë QV, të ndara sipas subjekteve zgjedhore. Kjo tabelë do të përmbledhë të dhënat e të dyja kutive sëbashku. Kjo tabelë rezultatesh i jepet Sekretarit të KZAZ-së, i cili do t’ia kalojë operatorit për hedhjen e të dhënave në aplikacionin kompjuterik, si rezultat paraprak, duke zbatuar procedurat përkatëse.
4. Pas përfundimit të numërimit të votave për çdo kuti votimi për subjektet zgjedhore të qendrave të votimit dhe nxjerrjes së rezultatit përfundimtar për çdo subjekt zgjedhor, vijon numërimi i votave preferenciale për kandidatët e listave shumëmemërore të partive politike dhe koalicioneve zgjedhore, duke ndjekur të njëjtën procedurë si në pikën 3 të këtij neni, si dhe duke plotësuar tabelën përmbledhëse të rezultateve për të gjithë QV-në, të ndara sipas kandidatëve të çdo subjekti.

Neni 4
Dispozita të fundit

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe administrata zgjedhore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
E.Meta _____
P.Doçaj _____
M.Çelmeta _____